

Mbahet mbledhja e radhës e Këshillit Drejtues të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren



KD-ja të mërkurën në sallën e mbledhjeve përkatësisht në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, mbajti mbledhjen e radhës ku në mbledhje morën pjesë: prof. asoc. dr. Naser Bajraktari (kryesues), dr. sc. Hajrije Skrelje , prof. asoc. dr. Rifat Morina, dr. sc. Kushtrim Gashi, prof. ass. dr. Rifat Hoxha, prof. asoc. dr. Drita Krasniqi, prof. ass. dr. Ylli Kortoçi, Rektori, prof. asoc. dr. Ismet Temaj, Sekretari i Përgjithshëm Burim Berisha, Kryetari i Studentëve Milot Krasniqi dhe Zyrtari Ligjor në KD Abdullah Etemi dhe Përparim Abdullahu.

Këshilli Drejtues mbajti mbledhjen e radhës me këtë rend dite:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Drejtues, të mbajtur më ;
3. Shqyrtimi i shkresave drejtuar Këshillit Drejtues;
4. Shqyrtimi i Raportit mbi mbarëvajtjen e procesit mësimor gjatë kohës së pandemisë.
5. Shqyrtimi i Raportit për menaxhimin e situatës dhe zbatimin e masave parandaluese ndaj virusit Covid-19.

Të ndryshme